



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 710 prot.

Tiranë, më 04. 05. 2021

V E N D I M

Nr. 72, datë 04. 05. 2021

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 136, datë 20.11.2020, e shtetases M. M., kundër L. M., në cilësinë e Drejtores së Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, Patos, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të vendbanimit¹ dhe çdo shkak tjetër²*.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në lidhje me diskriminimin e pretenduar, ankuesja ka parashtruar se:

Prej rreth 20 vitesh ushtron profesionin e mësuesit, fillimisht në Shkollën 9-vjeçare “Kostandin Peto”, Çlirim-Fier, e më pas, në vitin 2016, është transferuar në Shkollën 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, Patos.

Rreth 2 vite pas transferimit në këtë shkollë, drejtoresha L. M., zëvendësohet nga D. K., mësues bio-kimie dhe banor i zonës. Gjatë asaj periudhe, ankuesja sqaron se punonte 5 ditë në javë në shkollën vartëse Drenie me ngarkesë mësimore 20 orë në javë. Në vitin shkollor 2017-2018, drejtori i DAR Fier e emëron ankuesen si mësuese ndihmëse me normë mësimore 20 orë në javë.

Gjatë vitit shkollor 2018-2019, u largua nga detyra D. K. dhe në pozicionin e drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, u rikthye L. M. Në këtë periudhë, ankuesja ka punuar me normë mësimore 10 orë në shkollën vartëse Drenie dhe 10 orë në shkollën e Verrisë në Fier.

¹ Për shkak se ankuesja është e vetmja mësuese që banon në qytetin e Fierit dhe punon në shkollën “Sadush Dervishi”.

² Ankuesja nuk ka specifikuar një cilësi sa i përket këtij shkak.

Gjatë vitit shkollor 2019-2020, ankuesja thekson se një pjesë e normës së saj mësimore, disa orë të bio-kimisë i kaluan mësuesit të matematikës O. K., për të plotësuar atë me normë mësimore. Në këto kushte, ajo pretendon se pa dëshirën e saj dhe nën presionin e largimit nga puna, u emërua përsëri mësuese ndihmëse.

Pra, përsa më sipër, M. M. pretendon se me veprimet e mësipërme të ndërmarra nga ana e L. M., ka vënë në pozita diskriminuese në raport me mësuesit e tjerë të Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, për shkak se ajo nuk është banore e zonës në të cilën ndodhet kjo shkollë.

Aktualisht në këtë vit shkollor 2020-2021, në shkollën vartëse Drenie, 2 mësues meshkuj, E. S.-mësues cikli nga Patosi dhe O. K.-mësues matematike nga fshati Siqec, Patos, u janë caktuar 2 orë të Edukimit Mjedisor, për të cilat ankuesja pretendon se ja kanë hequr nga ngarkesa e saj mësimore për t’ia dhënë mësuesve të sipërcituar. Pavarësisht faktit që në shkollë mund të jenë edhe mësues të tjerë të cilët jetojnë në qytetin e Fierit, ata kanë lindur në zonat përreth shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”.

Sipas ankueses, gjatë këtij viti shkollor, është bërë shpërndarja e normës mësimore dhe lëndëve për të gjithë mësuesit, duke i hequr një pjesë të lëndëve të profilit ankueses, për t’ia dhënë mësuesve të tjerë të cilët janë banorë të zonës. Në këtë kuptim, ankuesja pretendon se, ky veprim i pabarabartë është bërë për faktin që mësuesit e zonës të vijnë në mësim në shkollën 9-vjeçare “Sadush Dervishi” dhe ajo të largohet nga puna, për shkak se është me banim në Fier.

Në përfundim, në muajin shtator 2020 e në vijim, ankuesja është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak se nuk plotëson normën mësimore me lëndët e profilit. Në këtë kuptim, diskriminimi sipas saj qëndron në faktin se i janë hequr me qëllim lëndët e profilit për të mbetur pa ngarkesë mësimore dhe për ta larguar përfundimisht nga detyra.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit në marrëdhëniet e punës dhe qëndrimin e saj në detyrë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”³, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me vendbanimin, pretenduar nga ankuesja si shkak diskriminues (neni 1⁴). Neni 3, i këtij ligji, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në Kreun II, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. LMD në nenin 12/1/c⁵, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet punëmarrësit në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu *pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7 të LMD-së, garantohej *ndaj çdo veprimi apo mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Pas analizimit paraprak të ankesës sipërcituar, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Njëpërmjet shkresës me nr. 1612/1 prot., datë 26.11.2020 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁶ Drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, Patos, lidhur me pretendimet e ankueses.

⁴ Neni 1, të ligjit nr. 10221/2010: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, **vendbanimin**, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

⁵ Neni 12/1/c, të ligjit nr. 10221/2010: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo **lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**.”

⁶ Është kërkuar konkretisht:

- Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Informacion lidhur me normën mësimore dhe lëndët për secilin mësues të shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi” dhe vartëse të saj, për vitet shkollore 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021.
- Informacion lidhur me vendlindjen dhe vendbanimin e secilit mësues të Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi” dhe vartëse të saj.

Në përgjigje përsa më sipër, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, me anë të shkresës⁷ nr. 30 prot., datë 09.12.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...M. M. është emëruar mësuese në shkollën 9-vjeçare “Sadush Dervishi” Ruzhdie në profilin Bio-Kimi në shkollën vartëse “Drenie” me Lëvizje Paralele të Detyruar në dt.15.09.2016. Në pozicionin e drejtorit të shkollës prej vitit 2014 e në vazhdim ka qënë L. M. e cila ka bërë lidhjen e Kontratës së Punës së M. M. më dt. 15.09.2016. Vetëm pak ditë pas emërimit të M. M. në këtë shkollë, L. M. është larguar nga pozicioni i drejtorit të shkollës dhe kaluar mësuese në këtë shkollë. Në pozicionin e drejtorit të shkollës është emëruar D. K. i cili ka qëndruar në këtë pozicion deri në fund të muajit Gusht të vitit 2018.

Në Shtator të vitit mësimor 2018-2019 është emëruar sërish L. M. Në vitin mësimor 2017-2018, M. M. ka punuar si mësuese ndihmëse me AK 20 orë. Në vitin mësimor 2018-2019 kjo mësuese punoi me 20 orë, 10 orë në shkollën vartëse “Drenie” dhe 10 orë me AK në shkollën qendër “Ruzhdie”. Po këtë vit mësimor për një periudhë 3-mujore Mars-Prill-Maj, ka punuar në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Verri”, 10 orë në profilin e saj Bio-Kimi dhe la 10 orë me AK që kishte në shkollën qendër “Ruzhdie”. Në vitin mësimor 2019-2020 ka punuar mësuese ndihmëse në shkollën qendër “Ruzhdie” pasi nuk plotësohej me normë mësimore në profilin e saj Bio-Kimi.

Në Qershor të vitit 2020 për shkak të rënies së numrit të nxënësve në shkollën “Ruzhdie” u bë vlerësimi i dosjeve për profilin Bio-Kimi për dy mësues të kësaj shkolle M. M. dhe B. M., për profilin e Arsimit Fillor shkolla vartëse Gjinoqarë dhe profili Histori-Gjeografi shkolla qendër “Ruzhdie”. Komisioni i vlerësimit, vlerësoi dosjet e dy mësuesve dhe mësuesi B. M. rezultoi me më shumë pikë se mësuese M. M.

Mësuese M. M. në Qershor të vitit 2020 përgatiti dosjen dhe bëri kërkesë për Lëvizje të Detyruar Paralele. ZVA Patos pasi shqyrtoi dosjet të profileve të ndryshme me Lëvizje të Detyruar Paralele nuk pati hapësira për ta sistemuar në profilin Bio-Kimi. Këtë e faktejmë me shkresën 864/4, datë 07.08.2020.

Në fillim të vitit mësimor 2020-2021 për shkak të situatës së pandemisë Covid-19 MASR dërgoi Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021 për të zhvilluar mësimin me turne apo grupe për shkolla të cilat kanë klasa me mbi 20 nxënës. Shkolla jonë ka vetëm dy klasa me mbi 20 nxënës klasa e 6-të dhe klasa e 7-të. Për arsye se këto klasa punojnë në grupe u krijua hapësira që mësuese M. M. të plotësohet me normë mësimore në këto lëndë: 4 orë Bio-Kimi, 1 orë Af. Tek., 1 orë Muzikë i ka në shkollën vartëse “Drenie”. Ndërsa 4 orë Ed. Mjedisi dhe 12 Ed. Fizik

-
- Informacion dhe kopje të vlerësimeve të punës së ankueses për vitet shkollore 2018-2019, 2019-2020 dhe 2020-2021.
 - Informacion dhe kopje të procedurës, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me M. M.
 - Kopje të shkresës Nr. 864/4 prot., datë 07.08.2020 të Zyrës Vendore Arsimore Patos, për lëvizjen paralele të ankueses.
 - Si dhe çdo shpjegim apo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1612/2 prot., datë 14.12.2020

i ka në shkollën qendër “Ruzhdie”, pra ka gjithsej 22 orë. Pra theksohet se këto orë janë vetëm për shkak të Covid-19. Nëse situata do të kalojë normalitetit kjo mësuese nuk plotësohet me orë dhe del pa ngarkesë mësimore pasi orët e Bio-Kimisë i kalojnë mësuesit që doli me pikë më shumë në vlerësimin e dosjeve.

3) Mësuesit që punojnë në Institucionin Arsimor të shkollës 9- vjeçare “Sadush Dervishi “Ruzhdie” si dhe shkollat vartëse Gjinoqarë dhe Drenie janë 21.

- Mësuesit që punojnë në shkollën 9-vjeçare “Sadush Dervishi “Ruzhdie janë 16:

NR. EMER MBIEMER VENDBANIMI

1. L. M.- Siqecë
2. z. B. M. - Mashkullore
3. znj. B. M. - Ruzhdie
4. B. K. - Patos
5. E. M. - Patos
6. E. R. - Fier
7. H. V. - Fier
8. L. H. - Fier
9. L. M. - Fier
10. M. T. - Patos
11. M. R. - Fier
12. O. Sh. - Patos
13. S. D. - Gjinoqarë
14. Sh. C. - Patos
15. T. F. - Patos
16. M. M.- Fier

Pra 12 mësues në zona urbane dhe 4 mësues në zona rurale.

- Në shkollën vartëse “Drenie” të shkollës 9-vjeçare “Ruzhdie” janë 3 mësues:

1. O. K. (Siqecë)
2. G. J. (Fier)
3. E. S. (Patos)

- Në shkollën vartëse Drenie janë 2 klasa kolektive:

1) Arsim Fillor klasat 3-4-5 dhe jep mësim mësuesi E. S.

2) Në AMU klasa kolektive e 6-të dhe e 8-të jep mësim O. K. i profilit Mat-Fizikë i cili e ka këtë klasë në kujdestari. Kjo klasë ka 6 nxenës. Mësuesi O. K. ka 27-të vite pune në këtë shkollë.

Gjithashtu, në këtë klasë përveç mësuesit të Matematikës japin mësim:

1. Mësuese e Gjuhë Letërsisë E. R..
2. Mësuese e Gjuhës së Huaj (Anglisht) G. T.
3. Mësuese e Bio-Kimisë M. M..

Mësuesit që punojnë në shkollën vartëse “Gjinoqarë” të shkollës 9-vjeçare “Ruzhdie” janë 2:

1. Sh. Y.- Gjinoqarë
2. N. G.- Gjinoqarë

Këtë vit mësimor për shkak të situatës Covid -19 ku klasat me mbi 20 nxënës u ndan në grupe ku u krijuan hapësira të cilat mundësuan që kjo mësuese të sistemohej me orë mësimore, por ka pak orë në profilin e saj në shkollën ku kjo mësuese është me vendim “Drenie”.

3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, në datën 11.02.2021, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike. Seanca u zhvillua me pjesmarrjen e ankueses dhe Zyrës Vendore Arsimore Patos, përfaqësuar nga juristi M.Gj., me autorizim Nr. 153/3 prot., datë 08.02.2021. Në seancë nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga Shkolla 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, Patos, të cilët njoftuan nëpërmjet e-mailit, për mosprezencën e tyre për shkak të gjendjes shëndetësore.

Në vijim të seancës M. M. parashtroi edhe një herë shkurtimisht situatën diskriminuese të pretenduar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit. Në pretendimet e saj ankuesja ka sqaruar faktin se orët e profilit të saj janë dhënë mësuesve të Matematikës dhe Histori-Gjeografisë, duke i dhënë asaj orë të tjera jashtë profilit si p.sh.: Edukim Fizik apo Muzikë.

Nga ana e përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, u sqarua se arsyet që çuan në nisjen e procedurave për zgjidhjen e kontratës së punës me M. M., kanë qënë: reduktimi i numrit të nxënësve të shkollës dhe i normës mësimore të lëndëve të profilit të saj. Procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës nuk lidhen me faktin që ankuesja nuk është banore e zonës së shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi” Ruzhdie, por për arsyet e parashtruara më sipër. Në përfundim të pretendimeve të parashtruara, përfaqësuesi i DRAP Fier, sqaroi se ankuesja ka paraqitur ankim në disa institucione, si: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Platëforma e Bashkëqeverisjes etj., për të cilat i është kthyer përgjigje.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja shtoi në kërkimet e saj si shkak tjetër diskriminues faktin që nuk është votuese në zonën ku punon.

4. Me e-mailin dt. 10.02.2021, nga ana e shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi” Ruzhdie, u informua Komisioneri, duke prapësuar ndër të tjera se: “...Në vitin mësimor 2019 –2020 mbyllet një klasë në shkollën qëndër ‘Ruzhdie’. Kjo mësuese kalon sërish si mësuese ndihmëse me 20 orë me AK. Në shkollën vartëse ‘Drenie’ për këtë vit mësimor ishin vetëm 4 nxënës: 2 nxënës në klasën e VII –të dhe 2 nxënës në klasën e IX –të. Në këtë shkollë jep mësim mësuese e profilit Gjuhë-Letërsi, mësuese e Gjuhës huaj (Anglisht) dhe lëndët shkencore i mbulon mësuesi i profilit Matematik –Fizik, O. K., i cili ka klasën në kujdestari dhe është mësues i cili ka 30 vite punë në këtë shkollë me shkollën e parë të kualifikimit ‘Mësues mjeshtër’. Gjithashtu, ky mësues jep edhe lëndën e Matematikës, e cila është lënda e Provimit të Lirimit e klasës së IX—të. Pra, e citoj se me 4 nxënës në

⁸ Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

këtë shkollë japin mësim O. K. me ngarkesë të plotë mësimore 20 orë, mësuesja e Anglishtes mer 3 orë, mësuesja e Gjuhës Shqipe mer 8 orë (5 orë Gjuhë Shqipe, 1 orë Teatër, 1 orë Qytetari, 1 orë Muzikë). Orët e tjera i kalojnë mësuesit O. K.

Për këtë vit mësimor 2019-2020 duhej padiskutim të bëhej vlerësimi i dosjeve, por duke u nisur nga pjesa humane vlerësimin e bëra, por jo ta vija në zbatim dhe kjo mësuese punoi me kontratë definitive dhe për vitin mësimor 2019-2020.

Në Qershor të vitit 2020, u bë parashikimi i ngarkesës mësimore për vitin 2020-2021, duke u mbështetur në Udhëzimet e MASR. Nisur nga rënia e numrit të nxënësve dhe mosplotësimin me ngarkesë të plotë mësimore të mësuesve bëhet vlerësimi i dosjeve në profilet më të rrezikuara nga Komisioni i Vlerësimit të dosjeve. Nga vlerësimi i dosjeve në profilin Bio-Kimi, mësuese M. M. rezultoi me më pak pikë. Shkresa me pikëzimin e dosjeve nisur në ZVA Patos ku mësuesit përgatitën dosjet për Lëvizje Paralele të Detyrueshme për shkak të mosplotësimin me ngarkesë mësimore në këtë shkollë.

Në fund të muajit Maj, klasat bëjnë përzgjedhjen e lëndës 'Kurrikul me zgjedhje', ku secila klasë disponon 2 orë. Klasa e 5-të Ruzhdie aktualisht klasa e 6-të dhe klasa AMU në 'Drenie' bëjnë ndryshimin e lëndës me zgjedhje ku këto orë i përkasin lëndës 'Edukim për të drejtat e njëriut'. Me kërkesë të nxënësve për ndryshimin e lëndës me zgjedhje nga 'Edukim mjedisi' në lëndën 'Edukim për të drejtat e njëriut', këta mësues dorëzojnë edhe procesverbalet në Drejtorinë e shkollës. ZVA Patos pasi shqyrtoi dosjet të profileve të ndryshme nis shkresën me Nr 864/4 prot., datë 07.08.2020, ku nuk ka patur hapësira për sistemimin e mësuese M. M. në profilin Bio-Kimi në këtë profil. Atëherë sipas kontratës së punës kaloi në Zgjidhjen e Kontratës së njëanshme mësimore të këtij profili në shkollën 'Ruzhdie'.

Theksoj se orët të mirëfillta të profilit Bio-Kimi janë gjithësej 15 orë, 11 orë në shkollën qendër 'Ruzhdie' dhe 4 orë në shkollën vartëse 'Drenie'. Në shtator duke u nisur nga situata e pandemisë Covid-19, kjo mësuese ka punuar me orë të dala nga ndarja e dy klasave në shkollën qendër: klasa e VI –të dhe VII –të, por jashtë profilit të vetë. 6 orë në shkollën vartëse 'Drenie', plus 16 orë në shkollën qendër 'Ruzhdie', ku 12 orë jep Edukim Fizik. Këto orë kjo mësuese do ti kishte deri në kthimin e mësimit në normalitet për shkak të situatës së Pandemisë Covid -19. Në bazë të procedurës së ndjekur M. M., i përfundoi zgjidhja e kontratës më datë 19.01.2021. Më datë 19.01.2021, në prani të Komisionit të Vlerësimit të Dosjeve, Drejtoria i dorëzoi vendimin për zgjidhjen e kontratës së punës. Po këtë datë Drejtoria i lidhi një 'Kontratë Pune me Afat të Përcaktuar' deri në kthimin e mësimit në normalitet për këtë vit mësimor për shkak të Pandemisë Covid -19, e cila është firmosur nga vetë mësuesja...Gjithashtu, në drejtorinë e shkollës nuk është depozituar ankesë nga M. M., ku kjo mësuese të ketë ngritur pretendimin që është ushtruar dhunë dhe terror psikologjik, diskriminim nga drejtoresha e shkollës, stafi pedagogjik apo nxënësit e kësaj shkolle...”.

5. Me shkresën Nr. 153/2 prot., datë 08.02.2021, DRAP Fier informoi Komisionerin lidhur me shqyrtimin e kërkesave/ankesave të M. M., drejtuar MASR-së, DRAP Fier dhe Portalit të Bashkëqeverisjes.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë dhe më pak të favorshëm

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja është mësuese prej rreth 20 vitesh. Në vitin 2016, është transferuar me Lëvizje Paralele të Detyruar mësuese në shkollën 9-vjeçare “Sadush Dervishi” Ruzhdie, në profilin Bio-Kimi, në shkollën vartëse “Drenie”. Në momentin e emërimit, në Shkollën “Drenie”, në pozicionin e Drejtorit ishte L. M. Rreth 2 vite pas transferimit, L. M. zëvendësohet nga mësuesi D. K., mësues bio-kimie dhe banor i zonës, i cili ushtroi këtë detyrë (të drejtorit të shkollës), deri në muajin Gusht 2018.

Në vitin mësimor 2016-2017, në shkollën vartëse “Drenie” (të shkollës “Sadush Dervishi”) ishin dy klasa kolektive: klasa e VI-të dhe e IX-të, ku ankuesja punoi me kohë të plotë mësimore, ku një pjesë të ngarkesës mësimore e plotësonte me profilin Bio-Kimi, ndërsa një pjesë jashtë profilit.

Në vitin shkollor 2017-2018, ankuesja është emëruar mësuese ndihmëse me normë mësimore të plotë 20 orë në javë. Gjatë kohës që ka ushtuar këtë detyrë, ankuesja është trajnuar për zhvillimin e mësimin me fëmijët me aftësi të kufizuara.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, evidentohet se numri i nxënësve në shkollën vartëse Drenie, në 3 vitet e fundit ka qënë si më poshtë:

| Numri i nxënësve në shkollën vartëse “Drenie” në AF ⁹ dhe AMU ¹⁰ | | | | |
|--|-----------|-----------|------------------------|---------------------------|
| | | | Totali i nx. Drenie | Shkolla S. D. në total |
| 2018-2019 | AF 10 nx. | AMU 8 nx. | 18 nxënës | 201 nxënës |
| 2019-2020 | AF 9 nx. | AMU 4 nx. | 13 nxënës | 191 nxënës |
| 2020-2021 | AF 7 nx. | AMU 6 nx. | 13 nxënës | 190 nxënës |

⁹ Mbështetur në parashikimin e Nenit 2/2 të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuara: “Arsimi fillor” përbëhet nga gjashtë klasa, nga klasa e parë deri në klasën e gjashtë.

¹⁰ Mbështetur në parashikimin e Nenit 2/4 të Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuara: “Arsimi i mesëm i ulët” përbëhet nga tri klasa, nga klasa e shtatë deri në klasën e nëntë.

Gjatë vitit shkollor 2018-2019, në pozicionin e drejtorit të Shkollës 9-vjeçare “Sadush Dervishi”, u rikthye L. M. Në këtë periudhë, për shkak të rënies së numrit të nxënësve dhe mbylljes së njëres prej klasave kolektive, ankuesja ka punuar me normë mësimore të profilit të saj (Bio-Kimi) 10 orë në shkollën vartëse Drenie dhe 10 orë mësuese ndihmëse në shkollën e Verrisë në Fier. Po këtë vit mësimor, për një periudhë 3-mujore Mars-Prill-Maj, ka punuar në Shkollën e Mesme të Bashkuar “Verri”, 10 orë në profilin e saj Bio-Kimi, duke lënë 10 orët që kishte në shkollën qendër “Ruzhdie”, me nxënësin me aftësi të kufizuara.

Në vitin mësimor 2019-2020, sipas informacionit të sipërcituar në tabelë, numri i nxënësve ra me 5 nxënës më pak. Pra, nga 18 nxënës që ishin në Arsimin Fillor (në vijim AF) dhe Arsimin e Mesëm të Ulët (në vijim AMU), në 13 nxënës (9 në AF dhe 4 në AMU). Gjithashtu, në këtë vit mësimor 2019 –2020, për shkak të rënies së numrit të nxënësve në shkollën qendër “Ruzhdie”, u mbyll edhe një klasë.

Gjithashtu, në fund të muajit Maj 2020, klasa e VI-të në shkollën “Sadush Dervishi” Ruzhdie, dhe klasa e AMU-së në shkollën vartëse në Drenie, kanë kërkuar ndryshimin e lëndës me zgjedhje, ku orët e lëndës “Edukim mjedisor”, u ndryshuan në “Edukim për të drejtat e njeriut”, ku secila klasë disponon 2 orë.

Në këtë kuptim, ankuesja është caktuar mësuese ndihmëse në shkollën qendër “Ruzhdie”, pasi nuk plotësohej me normë mësimore në profilin e saj Bio-Kimi dhe disa orë të Bio-Kimisë për tu plotësuar me ngarkesë të plotë iu kaluan mësuesit të matematikës O. K.

Në Kreun 7, të Udhëzimit të MASR Nr. 13, datë 22.05.2019 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”, i ndryshuar, parashikohet se: “...

9. Për mësuesit që kanë mbetur pa ngarkesë mësimore, drejtori i institucionit arsimor dërgon në ZVAP listën emërore dhe vlerësimin e dosjeve të tyre, sipas shtojcës 2.1.

10. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga: - drejtori i shkollës (kryetar); - një mësues i shkollës që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar); - kryetari i këshillit të prindërve të shkollës (anëtar).

11. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë, ka vlerësuar dosjet e mësuesve të profilit/lëndës për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1, ka publikuar rezultatet me ID-të përkatëse dhe ka dërguar në ZVAP listën e mësuesve që mbeten pa ngarkesë me pikët e fituara nga vlerësimi i dosjeve.

12. Të gjithë mësuesve, që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe kanë mbetur të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës, me të drejtën e konkurrimit sipas këtij Udhëzimi...”.

Sipas informacionit të dhënë nga ana e L. M., pavarësisht faktit që numri i nxënësve kishte rënë dhe për rrjedhojë edhe numri i orëve mësimore, edhe pse duhej bërë vlerësimi i dosjeve dhe ndërprerja e kontratës së punës me M. M. që në vitin mësimor 2019-2020, kontrata e saj është shtyrë edhe për vitin pasardhës 2020-2021.

Në Qershor të vitit 2020 është bërë parashikimi i ngarkesës mësimore për vitin mësimor 2020-2021. Nisur nga rënia e numrit të nxënësve dhe mosplotësimin me ngarkesë të plotë mësimore të mësuesve, shkolla “Sadush Dervishi” me Urdhërin Nr. 2 dhe 3, datë 25.06.2020 e MASR, “Për ngritjen e Komisionit Përgjegjës për procedurat e lëvizjeve paralele në rastet e rezultimit pa ngarkesë mësimore të mësuesve për vitin mësimor 2020-2021 në profilet përkatëse”, në respektim të procedurave të parashikuara në Udhëzimin e MASR Nr. 13, datë 22.05.2019, krijoi komisionet përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve për mësuesit të cilët rezultojnë pa ngarkesë mësimore për vitin 2020-2021, në profilet Biologji-Kimi dhe Histori Gjeografi.

Referuar procesverbalit Nr. 2, datë 25.06.2020 “Për përcaktimin e mësuesit që rezulton tepër në profilin Biologji-Kimi shkolla Ruzhdie, pas verifikimit të dosjeve personale sipas shtojcës 2.1”, nga Komisioni për Vlerësimin e Dosjeve u analizuan dosjet personale të ankueses dhe mësuesit B. M.

Mbështetur në Shtojcën 2.1 të Udhëzimit të sipërcituar, vlerësimi i mësuesve bëhej mbështetur në 7 kritere, si më poshtë:

1. Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare DIND. Konvertimi i notës mesatare në pikë bëhet si më poshtë:

- M. M. - **0.5** pikë për shkak se nota mesatare e saj ishte **5.30**
- B. M. – **1.5** pikë, për shkak se nota mesatare e tij ishte **6.44**

2. Shkallët e kualifikimit:

- M. M.- Mësues specialist **kategoria II- 6 pikë** për vlerësimin “Mirë”
- B. M. - Mësues mjeshtër **kategoria I- 8 pikë** për vlerësimin “Mjaftueshëm”

3. Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:

- Të 2 mësuesit nuk kanë marrë asnjë pikë

4. Çertifikata trajnimesh:

- M. M. - **1** pikë për shkak se ka **deri në 3 kredite**.
- B. M. – **2** pikë, për shkak se ka **mbi 3 kredite**.

5. Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve:

- Të 2 mësuesit nuk kanë marrë asnjë pikë.

6. Vlerësimi i psikologut dhe i punonjësit social të institucionit arsimor:

- Të 2 mësuesit nuk kanë marrë asnjë pikë.

7. Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”.

- M. M. - 2 pikë për shkak se është vlerësuar “Shumë mirë”.
- B. M. – 2 pikë, për shkak se është vlerësuar “Shumë mirë”.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, ankuesja kishte grumbulluar një total prej 9.5 pikë, ndërsa mësuesi tjetër i Biologji-Kimisë, kishte grumbulluar 13.5 pikë. Pra, Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve, përcaktoi ankuesen me më pak pikë se mësuesin B. M.

Gjithashtu, nga vlerësimi vjetor i bërë nga ana e shkollës, të dy mësuesit janë vlerësuar në të njëjtin nivel dhe me vlerësimet maksimale.

Në vijim, mbështetur në shkresën Nr. 192 prot., datë 28.07.2020, shkolla “Sadush Dervishi”, iu drejtua me shkresë ZVA-së Patos për ta informuar lidhur me vlerësimin e dosjeve në profilet: Bio-Kimi, Histori-Gjeografi dhe arsim fillor, të cilat nuk plotësohen me ngarkesë mësimore. Në përfundim të shkresës, shkolla njofton ZVA-në Patos lidhur me emrat e mësuesve që duhet të bëjnë Lëvizje Paralele të Detyrueshme, pasi kanë rezultuar me më pak pikë, si më poshtë:

- S. D., profili Histori Gjeografi;
- M. M., profili Bio-Kimi;
- L. Sh., profili Arsimi Fillor.

Përsa më sipër, nga ana e drejtorisë së shkollës “Sadush Dervishi”, është dërguar në ZVA Patos lista emërore dhe vlerësimi i dosjeve të bëra nga Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve. ZVA Patos pasi shqyrtoi dosjet e profileve të Bio-Kimisë me Lëvizje të Detyruar Paralele, me shkresën Nr. 864/4 prot., datë 07.08.2020, informoi shkollën “Sadush Dervishi” se:

- Përsa i përket profilit arsimor fillor ky vend definitiv në shkollën “Mustafa Matohiti”, vartëse “Oficinë”, i është ofruar kandidatit me më shumë pikë.
- Përsa i përket profilit Biologji-Kimi nuk ka orë të lira në shkollat që janë nën juridiksionin e ZVAP Patos.
- Përsa i përket profilit Matematik-Fizikë janë 5 orë të lira në shkollën “Sotir Kola”, Belinë dhe 5 orë në shkollën “Mustafa Matohiti”.
- Përsa i përket profilit Histori-Gjeografi mësuesi do të plotësohet me orë mësimore në shkollën “Mustafa Matohiti”.

Në kuptim përsa më sipër, për mësuesen e profilit fillor L. Sh. dhe ankuesen nuk ishte mundësia për t'i sistemuar në shkollat që ka nën administrim ZVAP Patos. Për këtë është vënë në dijeni edhe ankuesja me shkresën Nr. 545/3 prot., datë 30.09.2020, me lëndë “Kthim përgjigje”, të DRAP Fier.

Në këtë vit mësimor 2020-2021 në shkollën vartëse “Drenie”, ndjekin mësimin 4 nxënës, 2 nxënës në klasën e VII-të dhe 2 nxënës në klasën e IX-të. Në këtë shkollë jep mësim një mësuese e profilit Gjuhë-Letërsi, një mësuese e Gjuhës huaj (Anglisht) dhe lëndët shkencore i mbulon mësuesi O. K., i profilit Matematikë-Fizikë, i cili ka klasën në kujdestari dhe është mësues i cili ka 30 vite punë në këtë shkollë me shkallën e parë të kualifikimit “Mësues mjeshtër”. Gjithashtu, ky mësues jep edhe lëndën e Matematikës, e cila është lënda e Provimit të Lirimit të klasës së IX-të.

Përsa më sipër, në kushtet kur ankuesja kishte mbetur pa ngarkesë mësimore, nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, me shkresën Nr. 7 prot., datë 02.10.2020, M. M. është njoftuar për nisjen e procedurave të zgjidhjes së njëanshme të marrëdhënive të punës dhe për t'u paraqitur në takim në datën 13.10.2020, për të biseduar në lidhje me ndërprerjen e kontratës së punës.

Bazuar në nenin 144/1 të Kodit të Punës parashikohet : *“1. Pas kohës së marrjes në provë, kur punëdhënësi mendon të zgjidhë kontratën e punës, ai duhet të njoftojë me shkrim punëmarrësin të paktën 72 orë para takimit dhe të bisedojë me të.”*. Sa më sipër, njoftimi i është komunikuar ankueses dhe ankuesja ka refuzuar të paraqitet, si dhe rezulton se është respektuar detyrimi ligjor që njoftimi për takimin duhet të realizohet të paktën 72 orë para takimit. Në datën 13.10.2020, rezulton të jetë realizuar takimi midis Shkollës “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, ndërsa ankuesja nuk është paraqitur, fakt ky që pasqyrohet në procesverbalin me nr. 9 prot, datë 13.10.2020. Nga përmbajtja e këtij procesverbali punëdhënësi deklaroi se shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është rënia e numrit të nxënësve dhe mbyllja e klasave. Nga përmbajtja e procesverbalit rezulton se ankuesja nuk ka marrë pjesë në takim. Lidhur me mospjesëmarrjen në takim, siç ka cituar edhe në ankesë, ajo ka refuzuar një gjë të tillë edhe pse ka patur dijeni mbi shkresat e dërguara nga ana e shkollës.

Bazuar në nenin 144/3 të Kodit të Punës parashikohet se: *“3. Zgjidhja njoftohet me shkrim, brenda një afati nga 48 orë deri në një javë pas takimit.”*. Ndërkohë që sipas nenit 144/3 të Kodit të Punës, zgjidhja e kontratës së punës duhet të ishte njoftuar pas këtij takimi dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë dispozitë, pra brenda 48 orëve deri në 1 javë pas takimit. Me shkresën nr. 12 prot., datë 19.10.2020, Shkolla “Sadush Dervishi” Ruzhdie, ka vendosur lirimin nga detyra të ankueses, duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës më datë 19.01.2021, në respektim të nenit 143 të Kodit të Punës, i cili parashikon se: *“Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej dy javësh, kur marrëdhënia e punësimit ka zgjatuar deri në gjashtë muaj, prej një muaji, për*

kohëzgjatjen mbi gjashtë muaj deri në dy vjet, prej dy muajsh, për kohëzgjatjen mbi dy vjet deri në pesë vjet, dhe prej tre muajsh, për kohëzgjatjen për më shumë se pesë vjet.”.

Duke u bazuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shkolla “Sadush Dervishi”, Ruzhdie ka respektuar procedurën e parashikuar nga neni 144, të Kodit të Punës për zgjidhjen e kontratës së punës.

Në Kreun II/D të Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, përcaktohet norma mësimore javore e mësuesve dhe drejtuesve. Në pikën D/3, përcaktohet se: “Mësuesi i gjuhës shqipe, i gjuhës së huaj, i matematikës, i fizikës, i biologjisë, i kimisë, i informatikës, i historisë, i gjeografisë, mësuesi në shkollat e arsimit special: 20 orë në javë.”

Në pikën 1 të Kreut V të Udhëzimit, citohet se: “Mësuesi i arsimit parauniversitar e plotëson normën mësimore javore me lëndë të profilit të tij. Kur nuk ka orë të mjaftueshme në profilin e tij, ai ngarkohet me orë të profileve të përfaqëta, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij Udhëzimi.”

Për shkak të rënies së numrit të nxënësve dhe ngarkesës mësimore, aktualisht në profilin Bio-Kimi zhvillohen gjithsej 15 orë: 11 orë në shkollën qëndër “Ruzhdie”, nga mësuesi B. M. dhe 4 orë në shkollën vartëse “Drenie”, të cilat i zhvillon ankuesja. Në kushtet që mësuesi B. M., ka dalë i pari nga vlerësimi i dosjeve, të profilit Bio-Kimi, i është dhënë ngarkesa mësimore e orëve të profilit dhe është plotësuar me orë të tjera jashtë profilit, duke qënë se asnjë nga mësuesit e profilit Bio-Kimi, nuk arrinte të plotësonte normën mësimore prej 20 orësh në javë me lëndë të profilit Bio-Kimi. Pra, mësuesi B. M. zhvillon 11 orë lëndë të profilit, 4 orë edukim mjedisor dhe 6 orë Aftësim Teknologjik.

Në shtator të vitit 2020, referuar Udhëzuesit të MASR “Për fillimin e vitit shkollor 2020-2021”, duke u nisur nga situata e pandemisë Covid-19, klasat duhet të përbëheshin nga një numër i kufizuar nxënësish prej 20. Në këto kushte, referuar informacionit të dhënë nga ana e palëve, në shkollën “Sadush Dervishi” Ruzhdie, u ndanë klasa e VI-të dhe e VII-të, secila në dy të tilla. Nga ndarja e këtyre klasave, u krijua mundësia që ankuesja të plotësohej me ngarkesë mësimore jashtë profilit të saj, duke dhënë 6 orë në shkollën vartëse “Drenie” dhe 16 orë në shkollën qëndër “Ruzhdie”. Duke qënë se mbetën disa orë të lira, nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, ankueses iu ofrua mundësia për të vijuar marrëdhëniet e punësimit deri në përfundim të situatës së pandemisë Covid-19. Kjo marrëveshje u materializua përmes kontratës me afat të përcaktuar (deri në përfundim të vitit mësimor 2020-2021), nënshkruar nga ankuesja dhe shkolla “Sadush Dervishi”, Ruzhdie.

Aktualisht, ankuesja është plotësuar me orë mësimore në këto lëndë: 4 orë Bio-Kimi, 1 orë Aftësim Teknologjik, 1 orë Muzikë, të cilat i zhvillon në shkollën vartëse Drenie, ndërsa 4 orë Edukim Mjedisi, 12 orë Edukim Fizik, i zhvillon në shkollën “Sadush Dervishi” Ruzhdie. Pra, në total ankuesja është e plotësuar me ngarkesë të plotë mësimore 22 orë.

Pika 3 e Shtojcës bashkëlidhur Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, përcaktohen mësuesit sipas profileve, për arsimin e mesëm të ulët:

| Nr. | Lëndët | Profili i kërkuar | Profili i përafërt |
|------------|-----------------------------------|--|---|
| 1. | Gjuhë shqipe | Gjuhë shqipe-letërsi | |
| 2. | Gjuhë e huaj | Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht...) | Gjuhë e huaj: e mesme e gjuhëve të huaja e profilizuar për mësuesi, shkalla I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar) |
| 3. | Matematikë | Matematikë | Matematikë-Fizikë |
| 4. | Fizikë | Fizikë | Matematikë-Fizikë |
| 5. | Kimi | Kimi | Bio-Kimi, Biologji |
| 6. | Biologji | Biologji | Bio-Kimi, Kimi |
| 7. | Histori | Histori | Histori- Gjeografi, Histori |
| 8. | Gjeografi | Gjeografi | Histori- Gjeografi, Gjeografi |
| 9. | Qytetari | Shkenca sociale | Histori- Gjeografi, Histori, gjeografi, gjuhë shqipe-letërsi |
| 10. | Art pamor | Arte figurative | E mesme artistike e profilizuar për mësuesi, shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar) |
| 11. | Muzikë | Arte muzikore | E mesme e muzikës e profilizuar për mësuesi, shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar) |
| 12. | Kërcim | Arti skenik (koreografi) | Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose edukim fizik |
| 13. | Teatër | Arti skenik (aktrim, regji) | Mësuesit e arteve (art pamor, muzikë) ose gjuhë shqipe |
| 14. | Aftësim teknologjik | Shkencat e natyrës, TIK, | Shkencat e natyrës, Informatikë |
| 15. | Edukim fizik, sporte dhe shëndeti | Edukim Fizik | Mësues i fizkulturës shkalla e I e kualifikimit (sipas përcaktimeve të ligjit nr. 69/2012, të ndryshuar) |
| 16. | TIK | Informatikë, TIK, Matematikë-Informatikë | Matematikë, Fizikë |

Në Kreun II/A të Udhëzimit Nr. 30, datë 12.09.2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”, përcaktohet numri i nxënësve që të formohet një klasë. Në pikën A/1, përcaktohet se: “Klasat e veçanta në zonat urbane të formohen me jo më pak se 15 nxënës dhe në zonat rurale të formohen me jo më pak se 10 nxënës.”.

Në Kreun II/B të Udhëzimit të MASR, citohet shprehimisht se: “Në institucionet arsimore, kur nuk plotësohet numri i nxënësve në përputhje me pikën A/1 të Kreut II të këtij udhëzimi, mësimi organizohet në klasa të bashkuara. Numri i klasave përcaktohet sipas këtij rregulli:

1. Në arsimin fillor (klasat I-V)
 - a) Një klasë, kur numri i nxënësve në klasat I-V është deri në 10.
 - b) ...
 - c) ...
 - d) ...
2. Në arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX)
 - a) Një klasë, kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është deri në 10
 - b) ...
 - c) ...
 - d) ...”

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, rezulton se për shkak të numrit të kufizuar të nxënësve, të gjithë mësuesit, pjesë e stafit, zhvillojnë orë jashtë profilit të tyre për tu plotësuar me ngarkesë të plotë. Gjithashtu, në interpretim të udhëzimit të sipërcituar dhe numrit real të nxënësve, shkolla vartëse Drenie, nuk plotëson as numrin minimal që duhet për të formuar klasat kolektive.

Në përfundim, Komisioneri gjatë analizës së informacionit dhe provave të sipërcituara, konstatoi se:

- Nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, janë ndjekur të gjithë procedurat dhe hapat ligjor/nënligjor, për njoftimin dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen;
- Gjatë vlerësimeve vjetore të kryera për ankuesen dhe mësuesin B. M., shkolla “Sadush Dervishi”, ka mbajtur të njëjtin vlerësim për të dy palët;
- Në momentin që shkollës “Sadush Dervishi”, iu dha mundësia për t’i ofruar një vend pune të përkohshëm edhe pse jashtë profilit të saj, ja ofroi atë ankueses.
- Rënia e numrit të nxënësve dhe rrjedhimisht i orëve të profilit çuan në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ndërmjet ankueses dhe shkollës “Sadush Dervishi”.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në

cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se shkolla “Sadush Dervishi” Ruzhdie, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues. Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, për shkaqet e pretenduara nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7/1, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetases M. M., nga ana e shkollës “Sadush Dervishi”, Ruzhdie, për shkaqet e pretenduara prej saj.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Vendbanimi)

(Fusha: Punësim)